

Pushteti i vendosur për ta vazhduar punën e Kuvendit, opozita e akuzon për dështim || PAGE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

MUSTAFA: QEVERIA KURTI MUND TË RRËZOHET ME STRATEGJI MË TË FORTË OPOZITARE



Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, ka thënë se dhunën në Kuvend dhe jashtë tij e ka instaluar Lëvizja Vetëvendosje dhe tashmë kjo është "sëmundje" që po

trashëgohet. Duke folur për opozitën e tanishme, ai thotë se në kohën kur ka qenë kryeministër opozita e atëhershme është imponuar më shumë përmes

dhunës sesa, siç shprehet ai, ka pasur forcë. Mustafa ka thënë se qeveria Kurti mund të rrëzohet me një strategji të fortë opozitare, duke i bërë thirrje opozitës për koordinim

AKTUALE



PAPA KËRCON VEPRIME URGJENTE NGA BOTA KUNDËR NDRYSHIMEVE KLIMATIKE F. 2

UP-ja SË SHPEJTI ME KURSE TË GJUHËS ROME F. 6

OSMANI NUK DO TA NËNSHKRUAJË LIGJIN PËR PAGËN MINIMALE PA VENDIM TË KUSHTETUESËS F. 6

EKONOMI



ANKANDI SOLAR, KURTI THIRRJE INVESTITORË QË TË MARRIN PJESË F. 7

THEMELIMI I ODËS EKONOMIKE KOSOVARO-JAPONJEZE, YAMANAKA: PRESIM RRIJTE TË ZHVILLIMIT TË BIZNESIT MES DY VENDEVE TONA F. 7

SPORT



'DARDANËT' SOT UDHËTOJNË PËR NË DANIMARKË, FBK-JA KËRCON MBËSHETJEN E BASHKATDHTARËVE F. 10



PENDAROVSKI NË SHOIPËRI: MUNGESA E TRI SHTETEVE NË BALLKANIN E HAPUR, MANGËSI E MADHE || PAGE 3

KURTI: BRUKSELI DHE WASHINGTONI BËNË PADREJTËSI KUR VENDOSËN MASA NDËSHKUESE NDAJ MEJE DERISA E FALËN VUÇIËN || PAGE 7



RENOVA
PUTZ
Miqiulal Zhungjll - Yllend
Gardh - Yllend
E-mail: renovant.net.mk
Tel: +386 44 407 232 / +386 44 407 100
+386 44 407 755
Fax: +386 44 407 233
064-077 41 501 281

PRINCESHA
NDERTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princeshatir.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYRKOL - BUNJAKOL - CUROFASADË

Kolegiji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
020 500 070 | 045 500 070
045 500 070 | 045 500 070

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SHIPA BESHKALIMAN VITENNA INSURANCE GROUP BILA
DITTA SHIPITJE
Shkup - Prishtinë - Vazhër - G. Prizrenin - Korçinë
Tel: +386 70 538 246 507 Fax: +386 70 538 246 302
E-mail: info@sigma.si.net | www.sigma.si.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kryeministria italiane: Rrjedhat e emigrantëve i dëmtojnë të gjitha shtetet

ROMË, 23 KORRIK - Rrjedhat ilegale të emigrantëve po i dëmtojnë të gjitha shtetet përgjatë Mesdheut, ka deklaruar të dielën kryeministria e Italisë, Giorgia Meloni, teksa u ka bërë thirrje vendeve që të luftojnë së bashku kundër trafikantëve të qenieve njerëzore.

Në kontrast me retorikën e saj të ashpër të së kaluarës, Meloni ka thënë në një konferencë ndërkombëtare në Romë se qeveria e saj është e hapur për pranimin e më shumë njerëzve përmes rrugëve legale, sepse "Evropës dhe Italisë u duhet emigracioni".

"Emigrimi masiv ilegal dëmton çdonjërin prej nesh. Askush nuk përfiton nga ai, përveç grupeve kriminale, që pasurohen në dëm të më të brishtëve, dhe të cilët përdorin fuqinë e tyre edhe kundër qeverive", është shprehur ajo më 23 korrik, raporton "Reuters".

Më herët, këtë muaj, Italia është zotuar se do të lëshojë 452 000 viza të reja pune për qytetarët e



vendeve joanëtare të Bashkimit Evropian, nga viti 2023 deri më 2025, duke rritur numrin e lejeve qdo vit në rekord 165 000 më 2025. Më 2019, para se

pandemia e Covid-19 ta godiste, Italia lëshoi vetëm 30 850 viza. Në konferencë, e cila synon të ndërtojë një partneritet

ndërmjet shteteve për një varg çështjesh, po marrin pjesë përfaqësues të shumë shteteve, përfshirë Tunizinë, Emiratet e Bashkuara Arabe, Qipron, Libinë

dhe të Bashkimit Evropian.

"Trafikuesit ndërkombëtarë të njerëzve nuk janë të mirësecardhur në vendin tonë", ka thënë presidenti tunizian Kais Saïed në konferencë. Meloni, e cila drejton një qeveri të krahut të djathtë që nga tetori i vitit të kaluar, po angazhohet për të përfshirë vende të tjera në përpjekjet për ta frenuar emigracionin masiv dhe për t'i luftuar trafikantët.

Arritjet e emigrantëve në Itali janë rritur më 2023, teksa mbi 83 000 njerëz kanë ardhur deri më tani këtë vit, krahasuar me rreth 34 000 gjatë së njëjtes periudhë të vitit 2022.

Meloni ka thënë se fokusi kryesor i konferencës është mbështetja e zhvillimit në Afrikë, me "partneritete joabrigjate afatgjatë... të bazuara në respekt reciprok".

"Përditimi ka dhënë përshytyjen se është më i interesuar të japë mësimë sesa të ndihmojë... dhe kjo e ka bërë më të vështirë arritjen e përpamit për çështje strategjike", është shprehur ajo.

Papa kërkon veprime urgjente nga bota kundër ndryshimeve klimatike

VATIKAN, 23 KORRIK - Papa Françesku ka thënë të dielën se valët e fundit të të nxehtit në shumë pjesë të botës dhe përmbytjet në vendet si Konaia e Jugut kanë treguar se nevojiten më shumë veprime urgjente për t'i luftuar ndryshimet klimatike. "Ju lutem, ua përsëris thirrjen time udhëheqëse botërore të bëjnë dëkja më konkrete për të kufizuar emetimet ndotëse", ka thënë Papa më 23 korrik, në fund të një adresimi para turmave në sheshin e Shën Pjetrit në Vatikan. "Është shtë udhëheqëse, nuk mund të shpëtohet, i



prek të gjithë. Le ta mbrojmë shtëpinë tonë të përbashkët", është shprehur ai, raporton "Reuters".

Francesku i ka bërë thirrje botës të heqë dorë sa më parë nga karburantet fosile dhe e ka bërë mbrojtjen e mjedisit objektiv kyç të papatit të tij. Ai ka thënë më 2015, në enciklikën e tij "Ti qofsh lëvduar o Zot", se planeti "ka nisur t'i ngjashë gjithnjë e më shumë një grumbull të madh mbeturinash". Të dielën Papa ka shprehur solidaritetin e tij me ata që po

vuajnë nga kriza klimatike dhe me ata që po u ndihmojnë gjatë.

Disa pjesë të Jugut të Shteteve të Bashkuara të Amerikës janë goditur nga një valë rekorde e të nxehtit përderisa temperatura ekstreme janë regjistruar edhe në Kinë dhe në Evropën jugore, përfshirë Italinë dhe Greqinë. Një zjarr i egër në ishullin grek të Rodosit detyroi mijëra turistë dhe banorët të streheshin në shkollë dhe në stadume të mbyllura, të dielën, pasi ata u evakuuan nga fshatrat dhe qendrat pushimore bregdetare.

Përmbytje në Afganistan, 31 persona të vdekur

KABUL, 23 KORRIK - Të paktën 31 persona kanë humbur jetën dhe më shumë se 70 të tjerë janë lënduar pas përmbytjeve të shaktuarra nga shirat e rrëmbyeshëm në Afganistan gjatë tri ditëve të fundit, kanë njoftuar autoritetet e udhëhequra nga talibanët të dielën.

Një zëdhënës i talibanëve, Zabihullah Mujahid, ka thënë më 23 korrik se ndihma urgjente po dërgohet në zonën e

katastrofës, në qarkun e Jalrezit, në provincën Maidan Vardak, ku kanë vdekur 26 persona. Katër persona të tjerë kanë humbur jetën në Kabul, ndërsa në të dy zonat janë zhdukur rreth 40 persona.

Mujahid ka thënë se janë përkulluar thellë nga lajmi për vdekjen dhe zhdukurin e qytetarëve. "Janë shaktuar edhe disa humbje financiare", ka bërë me dije zëdhënësi. Zyra e guvernatorit provincial ka

thënë nëpërmjet një komunikate se qindra shtëpi janë dëmtuar apo shaktërruar, dhe se njerëzit e zhdukur besohet të jenë nën rrenojat e shtëpive të shembura. Sipas komunikatës, qindra hektarë tokë bujqësore janë përmbytur dhe shaktërruar, ndërsa autostrada ndërmjet kryeqytetit Kabul dhe provincës qendrore Bamijan është mbyllur për shkak të vërshimeve.



Pendarovski në Shqipëri: Mungesa e tri shteteve në Ballkanin e Hapur, mangësi e madhe

Faton DËRMAKU

Tiranë, 23 korrik - Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, ka shfaqur edhe një herë rezervat e tij për nisimën rajonale, Ballkani i Hapur, gjatë një vizite në Shqipëri të dielën.

Udhëheqësi maqedonas u takua me homologun e tij shqiptar, Bajram Begaj, në Pustec, ku jeton minoriteti maqedonas në Shqipëri.

Të dy presidentët folën më 23 korrik për marrëdhëniet e mira mes dy vendeve dhe për rrugëtimin e përbashkët drejt Bashkimit Evropian, por interesimi i gazetarëve bëri që deklarata e tyre për mediet të përgërdhesh të Ballkani i Hapur.

Presidenti maqedonas tha se mungesa e tri prej vendeve të Ballkanit Perëndimor në nisimën rajonale është mangësi e madhe për Ballkanin e Hapur, ku, pos Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, bën pjesë edhe Serbia. "Është e pakontestueshme, për vendet që janë pjesë e Ballkanit të Hapur, se ombrellë për të gjitha nisimat është Procesi i Berlinit", është shprehur Pendarovski. "Procesi i Berlinit ka marrëdhënie strukturore shumë më të sakta se Ballkani i

Hapur. Gjashtë shtete marrin pjesë në Procesin e Berlinit, ndërsa vetëm tri shtete në Ballkanin e Hapur, dhe kjo është një mangësi e madhe për Ballkanin e Hapur", ka deklaruar presidenti i Maqedonisë së Veriut.

Ndërkaq presidenti i Shqipërisë, Begaj, theksoi se vendimi për vazhdimin apo jo të nisimës rajonale i përket politikës. "Padyshim, çdo iniciativë rajonale është e mirë. Vendimarrësit e ekzekutivë politikë mendojnë për vazhdimin e një iniciative apo jo", është shprehur Begaj.

"Fati i kësaj nisime rajonale është ende i paqartë. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, deklaroi pak kohë më parë se misioni i Ballkanit të Hapur ka përfunduar, ndërsa kryeministria e Serbisë, Ana Bërnabiq, gjatë një takimi joformal të udhëheqësve të rajonit në Tiranë, theksoi se nisima vazhdon të ekzistojë dhe vazhdon me projekte të përbashkëta.

Rreth një vit më parë Pendarovski pati deklaruar se Ballkani i Hapur mund të jetë ide e mirë për bashkëpunimin mes shteteve të Ballkanit Perëndimor, por jo edhe alternativë për Bashkimin Evropian që, sipas tij, duhet të jetë prioritet për rajonin. Ai ka



shprehur rezervat e tij që prej fillimit të kësaj nisime. "Unë që në vitin 2019 kam pasur rezerva lidhur me këtë nisim dhe i kam thënë se cilat janë ato: të mos jetë si alternativë e Bashkimit Evropian e kështu me radhë...", ka thënë Pendarovski. "Unë nuk kam problem me këtë nisim dhe këtë ua kam thënë edhe iniciatorëve të saj, pasi e shoh se nuk ka komponentë politike, apo në thelb nuk është

alternativë për integrimin evropian", pati deklaruar Pendarovski. Nisma rajonale, që fillimisht u quajt Mini-Shengen, nisi më 10 tetor 2019 në Novi Sad të Serbisë dhe u firmos nga presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, dhe kryeministri i Atdhësisë dhe Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev.

Më 29 korrik 2021 ajo u pagëzua me emrin Ballkani i Hapur. Nisma u kundërshtua nga opozita në Shqipëri dhe u refuzua nga Kosova, Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kishte thënë më herët se nisima Ballkani i Hapur më shumë i ngjan një "Ballkani të hapur për ndikimet nga Lindja" sesa një nisim për treg të përbashkët rajonal.

Pushteti i vendosur për ta vazhduar punën e Kuvendit, opozita e akuzon për dështim

Prishtinë, 23 korrik - Partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, është e vendosur ta vazhdojë punën e Kuvendit të Kosovës pavarësisht prej përleshjes fizike në seancën e fundit dhe paralajmërimeve të organizatave të dala nga lufta se do i pengojnë deputetët të hyjnë në Kuvend pas përjashtimit të tyre nga rritja e pagës minimale. Mirëpo në Partinë Demokratike të Kosovës e akuzojnë mazhorancën se përmes polarizimit të skajshëm të opozitës, po dëshirojnë t'i mbulojë dështimet e qeverisë. Në anën tjetër, monitoruesit e punës së Kuvendit thonë se kresionet në Kuvend kanë tensionuar një klimë përçarëse brenda grupeve parlamentare në legjislativ dhe se mund ta dëmtojë mbarëvajtjen e regullit të seancave plenare.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Armand Muja, thotë për Kosova Press se Kuvendi i Kosovës do ta përmbyllë me sukses seSIONIN

pranveror dhe se askush nuk mund ta pengojë punën e këtij institucioni. Ai deklaroi se për shkak të vizitës së kryeparlamentarit Glauk Kaniçica në Strasburg të Francës nuk është mbledhur Kuvendi gjatë kësaj jave.

Deputeti i mazhorancës e akuzon opozitën, në veçanti deputetët e PDK-së, se kanë tendencë për përdorim dhune në Kuvend, siç thotë ai, për shkak të humbjes së privilegjeve financiare që i kanë pasur më herët. Deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka theksuar për Kosova Press se qeveria Kurti po tenton t'i mbulojë dështimet e veta duke provokuar dhe sulmuar opozitën. "Polarizimi rrjedh si rezultat i mosrealizimit të objektivave shtetërore të qeverisë. Në kuadër të dështimeve të tyre edhe politike, sferën ekonomike dhe atë të legjislacionit, takimë është orvatur që përmes zvendëskryeminitrit dhe ministrave të caktuar ta



provokojë opozitën. Parimisht ka dy vjet që opozita ka qenë më shumë sesa e heshtur

konstruktive, pasi vetëm në pjesën e legjislacionit kemi dhënë kontributin tonë

maksimal që të tejkalohet sfida të ballafaqohet shteti", thotë deputeti opozitar.



Mustafa: Qeveria Kurti mund të rrëzohet me strategji më të fortë opozitare

Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, ka thënë se dhunën në Kuvend dhe jashtë tij e ka instaluar Lëvizja Vetëvendosje dhe tashmë kjo është "sëmundje" që po trashëgohet. Duke folur për opozitën e tanishme, ai thotë se në kohën kur ka qenë kryeministër opozita e atëhershme është imponuar më shumë qeveria dhunës sesa, siç shprehet ai, ka pasur forcë. Mustafa ka thënë se përmasa Kurti mund të rrëzohet me një strategji të fortë opozitare, duke i bërë thirrje opozitës për koordinim

PRISHTINË, 23 KORRIK - Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, e akuzon kryeministrin Albin Kurti për tensionim të situatës në vend, në një intervistë për "KosovaPress", ai thotë se Kurti po krijon reagim ndërkomëtar dhe, sipas tij, po përpiqet të fitojë poenë për shtensionim të situatës. Mustafa thekson se Kurti s'mund t'i ikë zbatimit të marrëveshjes së njohjes reciproke me Serbinë, duke eskaluar situatën në veri. Ai thotë se marrëveshja e Ohrit është më e rëndë se ajo e 2013-s. Ndër të tjera, Mustafa flet edhe për Asociacionin dhe për masat e BE-së ndaj Kosovës.

Ish-kryeministri i Kosovës dhe ish-ideari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa,

deklaron se nuk ka pasur nevojë të tensionohet situata në veri të vendit dhe që kryetarët e komunave atje nuk kanë pasur nevojë të "instalohej në zyrat e tyre me njësi speciale të policisë".

Ai ka bindjen se situata në veri të vendit është ndërlikuar që nga viti i kaluar, kur është biseduar për targa e automjeteve e pastaj, sipas tij, me marrjen e masave të ndryshme në veri të vendit, siç thotë ai, që kanë qenë të pakordinuara me ndërkomëtarët. Mustafa potencon se kryeministri s'mund t'i ikë zbatimit të marrëveshjes së njohjes reciproke me Serbinë, siç nënvizon ai, përmasë veprimet të eskalimit të situatës në veri. Lidhur me marrëveshjen mbi

parimet për krijimin e Asociacionit të vitit 2015 ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Mustafa shprehet se dokumenti është bërë si obligim i tyre që të implementohet ligji për ratifikimin e marrëveshjes së parë, të vitit 2013, kur Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshjen e parë për normalizimin e marrëdhënieve. Sipas Mustafës, shumë më e rëndë është marrëveshja e Ohrit e arritur më 18 mars ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Të rëndë e sheh ai edhe çështjen e pozitës së Kishës Ortodokse serbe, e cila është paraparë në pikën e shtatë të marrëveshjes së Ohrit. Lidhur me draft-statutin e kryeministrit të Shqipërisë, Edi

Rama për Asociacionin, ish-kreu i LDK-së thotë se ajo nuk ishte detyrë e Ramës, por e Kurtit. Ai thotë se nuk mund të kritikohet kryeministri shqiptar për draft-statutin nëse qeveria nuk del me propozim të vetin. Mustafa flet edhe për masat e Bashkimit Evropian ndaj Kosovës. Derisa potencon se Kosova ka qenë e respektuar nga Bashkimi Evropian, ai shtron pyetjen se nëse BE-ja i tërheq masat ndaj Kosovës, "a do të jemi sikur në gjendjen që ishim më parë?".

Mustafa i quan tërësisht të gabuara deklaratat e ministres së Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, e cila, para dy javëve, në forumin e Dubrovnikut, i është referuar Bashkimit Evropian si "tigrë prej letre". Ai thekson se Kosova nuk mund ta bëjë asnjë hap pa BE-në.

Mustafa thekson se dhunën në Kuvend, por edhe jashtë saj, e ka instaluar Lëvizja Vetëvendosje me kohë dhe, sipas tij, kjo është "sëmundje" që po trashëgohet. Duke folur për opozitën e tanishme, ai thotë se në kohën

kur ka qenë kryeministër, opozita e atëhershme është imponuar më shumë përmasë dhunës sesa, siç shprehet ai, ka pasur forcë.

Ai thotë se opozita duhet të ketë koordinim mes vete. "Atëherë ne kemi pasur mbi 80 deputetë, diku arrinim 87 deputetë, do të thotë në atë periudhë opozita ka qenë një minoritet i veçantë, mirëpo edhe ashtu siç ishte, opozita ka qenë shumë e gjallë, ka qenë shumë e zëshme, ka qenë shumë vepruese, mos të them edhe shumë e dhunshme, sepse përmasë dhunës pastaj edhe është imponuar më shumë sesa që ka pasur forcë. Unë tani nuk preferoj në asnjë moment që opozita e tanishme të aplikojë dhunë në Kuvend ose format e dhunës të cilat i ka aplikuar Vetëvendosja atëherë, të cilat kanë lënë pasoja, që duken edhe tani. Mirëpo, mendoj se ata duhet të jenë në koordinim mes vete për një strategji elementare si duhet ta ndërtojë opozita. Kjo nuk nënkupton që dikush nga subjektet politike duhet ta

Kurti: Brukseli dhe Uashingtoni bënë padrejtësi kur vendosën masa ndëshkuese ndaj meje derisa e falën Vuçiqin

PRISHTINË, 23 KORRIK - Kryeministri Albin Kurti, në një intervistë për gazetën kroate "Večernji List", ka folur për zhvillimet e fundit në vend. Në këtë intervistë i pari i ekzekutivit nuk ka kursyer kritikën për bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për qasjen e tyre në raport me Kosovën dhe Serbinë. "Brukseli dhe Uashingtoni

kanë vënë bast për kalim e gabuar në Serbi, në presidentin e atjeshëm. Në fund doli që nuk ishte fare kalë, por dhelprë. Askush as nuk e ka imagjinuar që një vit e pesë muaj pas agresionit rus në Ukrainë, Serbia nuk do të vendosë sanksione ndaj Moskës, por madje do të lejonte që Sputniku të mbante bazën rajonale në Beograd. Në vend të reflektimit dhe

introspeksionit të tyre, ata më godasin mua", ka deklaruar Kurti për "VečernjiList". Kurti thotë se Brukseli dhe Uashingtoni bënë padrejtësi ndaj tij duke i vendosur masa ndëshkuese, derisa në të njëjtën kohë, sipas tij, falën presidentin e Serbisë. "Brukseli dhe Uashingtoni e lejuan Vuçiqin që të mos e nënshkruante marrëveshjen nga Brukseli dhe Ohri, pastaj

që ta shkelte atë marrëveshje dhe ja ju jemi në një situatë në të cilën ekziston asimetri drastike në qasje. Masa ndëshkuese ndaj meje, nga ana tjetër falje për presidentin Vuçiq. Kjo është një padrejtësi". Ai shprehet se masat ndëshkuese nga BE-ja do të jenë afatshkurtra. "Por thonë se këto masa do të jenë afatshkurtra, të përkohshme

dhe të ktheshme, andaj të shohim. Me faktorët ndërkombëtarë, edhe evropianët edhe amerikanët, kemi komunikim dhe koordinim të rregullt, por kemi edhe dallime të vogla, herë sa iu përket taktikave, ndonjëherë, eventualisht, strategjive. Por sa iu përket vlerave, interesave dhe qëllimeve, nuk kemi asnjë dallim", ka deklaruar Kurti.



Ardhja e mërgimtarëve në Kosovë, pritje deri në tri orë te Dheu i Bardhë



PRISHTINË, 23 KORRIK - Derisa mërgimtarët vazhdojnë të kthehen në Kosovë, këtë verë pika më e ngarkuar mbetet ajo e Dheut të Bardhë. Pasditen e së dielës, sipas raportimit të Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit, tregohet se te Dheu

i Bardhë pritet për të hyrë në Kosovë janë deri në tri orë, përderisa kolona në këtë pikë kufitare është 1.6 kilometra. Pritje për të hyrë në Kosovë ka edhe në pikën kufitare të Merdarit, por që nuk kalon 30 minuta derisa kolonat

janë deri në 150 metra. Në pikat e tjera kufitare nuk raportohen kolona, duke iu referuar të dhënave zyrtare. Një numër i madh i mërgimtarëve shfrytëzojnë edhe trafikuan ajror për të ardhur në Kosovë e për t'i kaluar pushimet vjetore.

lëshojë programin e vet dhe t'i bashkëngjitet një programi të subjektit tjetër. Por, në këtë rast, opozitarizmi duhet të ketë një zë të përbashkët në Kuvend, edhe të dinë këto subjektet politike se çfarë duan. S'mund të vijmë në situatë që një herë

dëshiron të bëhet një qeveri e unitetit kombëtar, edhe s'e di se si do të bëhet ajo qeveri", thotë ai. Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, ka thënë se qeveria Kurti mund të rrezohet me një strategji të fortë opozitare.

"Qeveria mund të rrezohet me një koncentrim dhe me një strategji më të fortë të opozitës, të shoqërisë civile dhe opinionit. Por, unë mendoj se kjo qeveri së pari e ka për obligim t'i kryejë detyrat e veta. Kjo qeveri e ka bërë një marrëveshje të

Brukselit, e ka bërë një marrëveshje të Ohrit, dhe kjo qeveri tani duhet që atë marrëveshje ta implementojë. A është marrëveshje e mirë apo s'është e mirë, është punë tjetër, mirëpo është një obligim shtetëror që e ka marrë

Republika e Kosovës dhe do të ishte e padrejtë që kjo qeveri tani ose ta rrezojë veten ose ta rrezojë dikush tjetër. Ndërkohë, obligimet që kanë marrë ndërkombëtarët mbesin obligime të dikujt që vjen pas", ka thënë Mustafa.

Osmani nuk do ta nënshkruajë Ligjin për Pagën Minimale pa vendim të Kushtetueses

PRISHINË, 23 KORRIK - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, nuk do ta nënshkruajë Ligjin për Pagën Minimale derisa Gjykata Kushtetuese të marrë vendim për të. Lajmin për Radion Evropa e Lirë e ka konfirmuar Bekim Kupina, këshilltar për medie i presidentes Osmani. Ai ka thënë se Gjykata e ka njoftuar të premten presidenten se grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe dy deputetë të tjerë e kanë kërkuar shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjit në fjalë. AAK-ja, parti opozitare në Kosovë ka thënë se përmes dërgimit të ligjit në Kushtetuese synon ta ndërë "një padrejtësi të madhe rreth pagës minimale". Ligji për Pagën Minimale është miratuar në lexim të dytë në Kuvendin e Kosovës më 13 korrik. Ligji parasheh rritjen e pagës minimale në 264 euro bruto, apo 250 euro neto, nga 130-170 sa është aktualisht. Mirëpo kundër miratimit të ligjit kanë dalë disa parti opozitare dhe veteranët e luftës, të cilët janë të pakënaqur për mospërfshirjen e Kozë e tyre në ndryshimet ligjore. Deri më 2017 pensioni i veteranëve nuk ka mundur të

jetë më pak se paga minimale në Kosovë, përkatësisht 170 euro. Kjo, njëherësh, vazhdon të jetë shuma që marrin ata. Organizata e Veteranëve e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL e UÇK-së) ka protestuar kundër ligjit më 15 korrik në sheshet kryesore të Prishtinës dhe ka parajllmëruar edhe protesta të tjera para Kuvendit të Kosovës. Kështuqëndruesisht, ligji nuk ka mundur të miratohet edhe me presidenten Osmani më 18 korrik dhe i kanë kërkuar asaj që të mos e dekretojë këtë ligj. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë më 15 korrik se shumë përfitimime për veteranët e luftës së fundit në Kosovë, por që përfittimet, sipas tij, nuk janë pagë. "Paga është për punë, ndërkaq përfittimet janë mirënjohje e shoqërisë, e cila i jepet veteranit të luftës për luftën çlirimtare, fitimtare, e cila është në burim të shtetësisë, pavarësisht e lirisë sonë". Kurti ka thënë se do të angazhohet në ligj të ri për veteranët, por që fillimisht faktet duhet të jenë të sakta. "Unë besoj se në luftën çlirimtare kanë marrë pjesë edhe më shumë se 60 mijë pjesëmarrës, mirëpo ka një lloj trefshimisht



numrit të veteranëve. Prandaj është e domosdoshme që gjërat t'i quajmë me emra adekuatë. Veteranët, sipas komandantëve të UÇK-së, janë rreth 20 mijë, ndërkaq nëse i bashkëngjishim edhe pjesëmarrësit, atëherë do të bëhen edhe më shumë se 60 mijë. Andaj unë jam që të kemi falënderimin e mirënjohjen si shoqëri për të gjithë, mirëpo nuk mund ta deformojmë luftën çlirimtare të UÇK-së". Ai ka thënë se shpreson që do të punojë me shoqatat e dala nga lufta për ta rregulluar këtë deçizje dhe që të krijohet mundësia që veteranët edhe të

punojnë. "Sepse një numër i madh i veteranëve të UÇK-së nuk janë për pension, nuk janë të rinj. Shumë prej tyre nuk i kanë as 50 vje". Nga Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe nga Organizata për Demokraci, Anti-korrupsion dhe Dinjitet, "Cohu", kanë luftuar se pa përfunduar procesi gjyqësor lidhur me rastin "Veteranët", pastrimi i listës së veteranëve nuk mund të bëhet. "Kështuqëndruesisht, Gjykata e Apelit më 26 prill të vitit 2022 e ka kthyer në rrygkim rastin e njohur si "Veteranët".

Në akuzën e ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, e cila ishte konfirmuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë më 19 qershor të vitit 2019, është ngritur dyshimi se për 19 500 persona është dhënë statusi i veteranit në mënyrë të paligjshme. Aktualisht, sipas të dhënave zyrtare nga Qeveria e Kosovës, statusin e veteranit luftëtar e kanë 53 188 persona, kurse sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 37 006 janë përfutës nga skema për veteranët e luftës.

UP-ja së shpejti me kurse të gjuhës rome

PRISHINË, 23 KORRIK - Për një komunitet është e rëndësishme ruajtja e gjuhës dhe mësimi i saj nga brezat e rinj. Në Qendrën e Gjuhëve në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" është planifikuar të hapet një kurs, ku për herë të parë do të mësohet gjuha bazë rome. Lindita Rugova, dekanë në Fakultetin e Filologjisë, thotë se aktualisht gjithçka është në fazën e planifikimit. "Unë e kam një ide të hap një kurs të gjuhës rome, jo program, jo departament, një kurs në Qendrën e Gjuhëve, të cilën e kemi themeluar para dy vjetësh... Të fillimjet ndoshta në vjeshtë", thotë Rugova për Radion Evropa e Lirë. Sipas saj, ideja është që kursi të bëhet fillimisht pa pagë. Ajo thotë se një mësimdhënës, i cili është gjuhëtar, duhet të jetë i Ministrisë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë konfirmim për REL-in se numri i mësimdhënësve të komunitetit rom në Kosovë është dhjetë, por nuk është e qartë se çfarë niveli të shkollimi kanë ata. Nga organizata "Roma Veritas" në Kosovë, qllim i së cilës është integrimi dhe përfshirja e komunitetit përmes arsimit, thonë se sigurimi i mësimdhënësve për kursin e



planifikuar mund të jetë sfidues. "Sa iu përket gjuhëtarëve, e di që janë 2-3 rrokmet e diplomë master në këtë fushë dhe ata kanë studiuar jashtë. Nuk ka asnjë mundësi që këta njerëz të studiojnë në Kosovë, sepse nuk ka një profil të tillë", thotë për Radion Evropa e Lirë, Avni Mustafa, përfaqësues i organizatës "Roma Veritas". Ngjashëm shpreh edhe Bashkim Ibrahimi, drejtor ekzekutiv i OJQ-së Advancing Together, e cila merrt me integrimin të komuniteteve në Kosovë. "Janë tre mësimdhënës të gjuhës

rome] dhe këta kanë qenë të sponsorizuar nga organizatat ndërkombëtare, nuk kanë qenë të sponsorizuar nga buxheti i Kosovës", thotë Ibrahimi për REL-in. Mësimi i gjuhës rome është akredituar nga Ministria e Arsimit në Kosovë në vitin 2010 si mësim plotësues dhe zgjedhor për nënxësit e interesuar vetëm në katër shkolla të komunës së Prizrenit. Nga kjo ministri kanë thënë se po bëjnë përpjekje që mësimi zgjedhor në gjuhën rome të zgjerohet edhe në komuna të tjera, përveç Prizrenit.

Rugova thotë se kursi do të ofrohet për personat mbi moshën 18-vjeçare dhe se atë do të mund ta ndjekin kandidatët me prejardhje të ndryshme etnike. "Ne do të kërkojmë që ta kemi [kursin] nga niveli A1, dm.th. nga niveli A1. Në qoftë se nga kandidatët e interesuar paraqiten edhe ata që dinë pak, që dinë [për nivelin] A2 po e zëmë, jo A1, atëherë ne duhet të bisedojmë me profesorin e lëndës [dhe] profesorin e propozojn një program të lëndës dhe në bazë të, ne vazhdojmë", thotë Rugova për Radion Evropa e Lirë. Gjuha rome në Kosovë ka 4 dialekte: Bugudziski, Arlisli e dialekt që flitet më së shumti nga romët në Graçanicë, Gjilan dhe Kamenicë, pastaj dialekti Gurbekji që përdoret në Pejë dhe Mitrovicë, si dhe dialekti i romëve nga Prizreni që përdoret kryesisht në media, thotë Mustafa nga organizata "Roma Veritas". "Jam pak i shqetësuar për kurrikullin apo planprogramin e kursit... Mendoj se na mungon pjesa gramatike. Nuk jam i sigurt se cili dialekt do të përdoret", thotë Mustafa. Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, në Kosovë jetojnë mbi 8 000 romë. Ata janë të shpërndarë kryesisht në komunat Ferizaj, Fushë-Kosovë, Gjakovë, Pejë dhe

Prizren. Prej tyre ka shpesh ankesa për diskriminim si në shkollim, ashtu edhe në punësim. Sipas të dhënave të publikuara në uebfaqen e Zyrës për Gënjeshje të Komuniteteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, norma e papunësisë të komunitetit rom, askali dhe egjiptian vlerësohet të jetë ndërmjet 90 për qind dhe 100 për qind. Jetëson kryesisht e sigurojnë duke bërë punë fizike. Shkollimi fillor në Kosovë është i detyrueshëm, por, sipas të dhënave të Ministrisë së Arsimit, në vitin shkollor 2021/2022 atë, ka më pak praktikues 43 nxënës romë, askalinj dhe egjiptianë. Mustafa, nga organizata "Roma Veritas", i bënë thirrje të rinjve të marrin pjesë në kursin e gjuhës rome kur të hapet posa, sipas tij, ai do të jetë një mundësi e mirë për të mësuar për njëri-tjetrin dhe për t'i kuptuar vlerat e historisë së njëri-tjetrit. "Nëse ekzistim mundësia, atëherë pse të mos marrësh pjesë? Unë po i ftoj të gjithë njerëzit që janë të interesuar, të mësojnë për kulturën e romëve. Ata duhet ta kuptojnë gjuhën, në mënyrë që të mund të komunikojnë me ta, që të mund të jenë më afër romëve dhe të kuptojnë vlerat se cilat janë vlerat e tyre", thotë Mustafa.

ANKANDI SOLAR, KURTI THIRRJE INVESTITORËVE QË TË MARRIN PJESË

PRISHTINË, 23 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u ka bërë thirrje investitorëve të marrin pjesë në ankandin e parë të Kosovës në energji solare. Kurti ka shkruar në "Twitter" se qeveria garanton proces të drejtë dhe transparent. "I ftojme investitorët në ankandin e parë në Kosovë, të PV diellore 100

MW, të cilin e kemi nisur me mbështetjen e USAID-it. Qeveria jonë garanton proces të drejtë dhe transparent, si dhe akses të përshkueshëm publik me 15 vjet të garantuara APD qira 30-vjeçare dhe lidhje afër rrjetit", ka shkruar Kurti. Njëpërmjet këtij ankandi pritet të bëhet instalimi i paneleve me kapacitet të prodhimit të 100

megavatëve të energjisë solare në një vlerë prej 75 milionë eurosh.

Ankandi është një proces konkurrues, njëpërmjet të cilit qeveria do të blejë energji elektrike që gjenerohet nga burimet e ripërtërishme. E kontrata e ankandit jepet në bazë të çmimit më të ulët të garantuar të blerjes.



Themelimi i Odës Ekonomike Kosovaro-Japoneze, Yamanaka: Presim rritje të zhvillimit të biznesit mes dy vendeve tona

PRISHTINË, 23 KORRIK - I ngarkuari për punë i Ambasadës së Japonisë në vendin tonë, Keisuke Yamanaka, duke folur për marrëdhëniet ekonomike ndërmjet dy vendeve, ka thënë se bizneset dhe Kosova ende duhet ta prezantojnë veten te populli japonez. Yamanaka në një intervistë për "Telegrafi"-n theksoi se investimet japoneze në vendin tonë janë të shumta. "Një prej bashkëpunimeve afatgjatë është sektori i Menaxhimit të Mbeturinave dhe deri më tani kemi dhuruar më shumë se 66 kamionë për bartjen e mbeturinave në Prishtinë dhe komuna të tjera përshirë Prizrenin, Ferizajin dhe vende të tjera, natyrisht duke punuar në ngritjen e kapaciteteve dhe asistencë teknike", thekson Yamanaka.

Ai tregon që janë duke punuar me komunat dhe organizatat joqeveritare dhe se deri më tani janë realizuar rreth 60 projekte. "Si Ambasadë po punojmë me komunat, por edhe me organizatat joqeveritare me projekte të vogla, atë që ne e quajmë Skema e Granteve të Vogla, si në arsim, në zhvillimin gjinor, bujqësi, zhvillim social, kamionë zjarfikës dhe deri më tani kemi realizuar 58 projekte", tregon ai.

Për shtu, Yamanaka ka folur edhe për misionin e Odës Ekonomike Kosovaro-Japoneze,



e funksionalizuar javë më parë. "Kjo Odë është regjistruar zyrtarisht në vitin 2021, por në kohën e Covid-19 ishte aktive, kështu që disa javë më parë anëtarët e Odës nisën zyrtarisht aktivitetin e tyre. Edhe në kemi marrë pjesë në këtë takim, prandaj kemi pritur që kjo Odë të jetë partneri ynë kryesor dhe

të zhvillojë tranzicionin ekonomik ndërmjet vendeve tona. E kam falën për sektorin privat", shpjegon Yamanaka.

I ngarkuari për punë i Japonisë në Kosovë pret që me anë të kësaj Odë të rritet bashkëpunimi biznesor hap pas hapi ndërmjet dy vendeve. "Kosova është ende një vend i ri,

Nuk mund të them se Kosova është e njohur mjaft në Japoni dhe Kosova ende duhet ta prezantojë vendin te populli japonez, biznesi japonez dhe, ndoshta, në sektorin e turizmit. Njëse kjo Odë do të vazhdojë t'i bashkojë afarishtë, pres që ne mund të zhvillojmë bashkëpunimin hap pas hapi",

shton i ngarkuari për punë i Japonisë në vendin tonë. Në këtë intervistë Yamanaka ka folur edhe për fushat dhe sektorët e mundshëm për bashkëpunim dhe pjesëmarrjen e Kosovës në Expo 2025 në Osaka në 15-vjetorin e marrëdhënies diplomatike ndërmjet Kosovës dhe Japonisë.


Vazhdon aksioni i KRU "Prishtina" për shkycjen e borxhlinjve dhe zbulimin e lidhjeve ilegale

PRISHTINË, 23 KORRIK - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" është duke vazhduar aksionin për shkycjen e borxhlinjve. Gjithashtu, KRU "Prishtina" po bën edhe zbulimin e kyçjeve ilegale. Deri më tani ka njoftuar se ka shkycur disa lidhje. "Lagja 'Premiere' në Çagllavicë në rrugën 'Xhemi Shea' sapo u shkyç, ujëmatisin e palegualizuar dhe me borxh 1 059.00 euro. Në Çagllavicë një shtëpi e palegualizuar u shkyç.


Veternik, lidhje ilegale, u shkyç. Inspektorët e KRU "Prishtina" në terren dhe sapo zbuluan kyçje ilegale në Çagllavicë dhe në rrugën "Muharrem Fejza". Vazhdojmë deri në orët e vona", thuhet në njoftimin e bërë nga KRU "Prishtina".

Në njoftimin e bërë për medie, KRU "Prishtina" thotë se i përkrah të gjithë inspektorët të cilët po vazhdojnë punën në temperatura të larta. KRU "Prishtina" para disa

ditëve ka njoftuar se borxhi ndaj shërbimeve të ujit është mbi 45 milionë euro. "Borxhi ndaj shërbimeve të ujit është mbi 45 milionë euro, 40 milionë euro nga sektori i amvisërisë dhe mbi 5 milionë nga sektori i bizneseve të vogla e të mëdha. Nuk ka ujë të pijshëm pa paguar fatet e ujit, ngaqë kemi një kosto të lartë të trajtimit të ujit dhe shpërndarjes përmes tubacioneve primare, sekundare e terciare deri te konsumatorët".



EURO GLASS
SEKURITË PËR QILKINGON
ZEVËRIT
Adri: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



'Dardanët' sot udhëtojnë për në Danimarkë, FBK-ja kërkon mbështetjen e bashkatdhetarëve

OPKA
BRE Veton ZYBERI

PRISHTINË, 23 KORRIK - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll ditë më parë e mposhti Zvicrën me rezultat bindës 76-49, në kuadër të Retinit të Tretë Parakualifikues për "Eurobasket 2025". "Dardanët" kanë vazhduar me përgatitje në Prizren, para udhëtimit në Danimarkë, i cili do të bëhet sot (e hënë). Kosova ndeshjen e radhës e zhvillon në mërkurën ndaj Danimarkës, kurse edhe optimizimi në ekipin përfaqësues është mjaftë i madh. Vetëm vendi i parë kualifikohet tutje. Federata e Basketbollit të Kosovës të dielen u ka bërë thirrje bashkatdhetarëve në Danimarkë që më 26 korrik të mbështesin ekipin përfaqësues të Kosovës në rregullimin e saj drejtë "Eurobasket 2025". "Danimarka dhe Kosova do të përballen të mërkurën (26 korrik) në Arena Naestved nga ora 19:00. Basketbollistët e Kosovës presin përkrahje nga bashkatdhetarët që jetojnë në



Danimarkë, ashtu si ka ndodhur në të gjitha ndeshjet që kanë luajtur si mysafirë. Ky takim është shumë i rëndësishëm për rregullimin e Dardanëve. Ndeshja është e vlefshme për Retinin e Tretë Parakualifikues për EuroBasket 2025", thuhet në njoftimin e FBK-së. Biletat kanë dalë në shihtë dhe mund t'i bilhen në faqen zyrtare të basketbollit të Danimarkës. Kapitani i Kosovës, Dardan Berisha ka thënë se ndeshja

ndaj Danimarkës od të jetë e vështirë, por synim është fitoria. "Do të vazhdojmë me këtë sistem. Shkojmë në Danimarkë për ta dhënë maksimumin. Do të jetë më vështirë, por do të shkojmë për të fituar. Do të shkojmë hap pas hapi. Po shpresoj që do të kemi rezultat të mirë. Duhet të qëndrojmë me këmbë në tokë. Nuk është bërë asgjë me këtë fitore. Na presin edhe tri ndeshje", ka deklaruar Berisha.

Kurti viziton Qendrën Nacionale të Xhudos: Qeveria po investon në fuqizimin e xhudos

PRË, 23 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti ka vizituar Qendrën Nacionale të Xhudos, ku u prit nga kryetari i Federatës së Xhudos të Kosovës, Agron Kuka dhe ekipi kampion i xhudistëve. "Ata na prezantuan projektin e zgjerimit të Qendrës Nacionale të Xhudos si pjesë e programit "Kosova, shtet i Xhudos", Qeveria po investon në fuqizimin e xhutarit i përbrenda vendit dhe në promovimin ndërkombëtar përmes mirëmbajtjes dhe rritjes së mëtejme të rezultateve të xhudistëve tanë", ka shkruar Kurti në "Facebook". Kurti ka theksuar se rezultatet dhe përfundimi i Dejës plotësohet me historinë dhe traditat e lashta, aty ku monumentet e trashëgimisë



kulturore krijojnë lidhjen mes së kaluarës dhe të ardhmës. "Nga Kulla e Ministrisë me një arkitekturë e sill të veçantë, i cili po restaurohet në bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtarë, rrugën e vazhduam në Çarshinë e Gjatë e

cila përkundër shkatërrimit masovik nga forcat serbe është rindërtuar. U ndalëm në dyqanin qindërfaqçar të brisqumestit Musa Gorani, që u restaurua dhe funksionalizua falë mbështetjes sonë direkte", ka shkruar Kurti.

SHKURT

Zyberaj shpallet kampion në garën e vrapimit malor në Turqi

Atleti i suksesshëm kosovar Erzen Zyberaj e ka regjistruar edhe një sukses tjetër në karrierën e tij sportive. Zyberaj është shpallur kampion në garën e vrapimit malor "Uludag Premium Ultra Trail 100km" në Bursa të Turqisë. "I lumtur për këtë sukses të arritur me shumë sakrificë dhe vendosmëri. Kjo fitore është dhuratë për Artën time. Dhuratë për datëlindjen tënd zemër. Faleminderit të gjithë shoqërisë që besuat në këtë rrugëtim timin dhe më ndihmuat që së bashku Kosovën ta shohim gjithmonë atje ku edhe e ka vendin sa më lart dhe me më dinjitetet", ka shkruar Zyberaj në "Facebook".

Kosova i mbyll me humbje kualifikimet për Kampionat Evropian

Përfaqësuesja e U22 e Kosovës i ka dhënë fund kualifikimeve të Kampionatit Evropian në Brno të Çekisë, me ndeshjen kundër Austrisë, të dielën pasdite. "Dardanët" pësuan disfatë me rezultat 3-1 (25-19, 11-25, 16-25, 19-25). Vashat kosovare treguan paraqitje brilante në setin e parë, të cilin arritën të fitojnë me gjashtë pikë diferencë. Megjithatë, në setet pasues, austriakët u konsoliduan dhe arritën përmbysjen, pavarësisht se ekipi ynë u mundua të bënte më shumë, sidomos në setin e katër. Pas kësaj ndeshjeje, Kosova U22 rikthehet në vendlidnje ku do të përgatitet për garat tjera, me një eksperiençë të re evropiane. Selektori Ylli Kadriu është shprehur tejet i lumtur me grupin e vajzave, me punën e bërë, atmosferën dhe paraqitjen e tyre në secilin secancë stërvitore dhe ndeshje.

Altea Hajrizi mposhtet nga austriakja në EYOF Maribor 2023

Altea Hajrizi ka garuar në EYOF Maribor 2023. Tenistja e Kosovës u mund nga austriakja, Johanna Corciotva, 2:0 në sete (6:1 dhe 6:3), në rethin e parë të garave individuale. Për dallim nga EYOF-i vitit të kaluar, Hajrizi këtë herë pati përmirësim më të madh, pavarësisht se nuk ia doli të fitojë meçin. Altea do të garojë edhe në çifte dhe mikse.

Verstappen nuk fal, 'mbretëron' në Hungari

Max Verstappen nuk fal. Piloti i Red Bull ka marrë triumfin e radhës, këtë herë ka fituar Çmimin e Madh të Hungarisë në Formula 1. Verstappen mbinte në një ditë të mirë, duke lënë mbrapa të gjithë rivalët. Vendi i dytë dhe i 3-të i takoi Norris dhe Perez, ndërsa topeshija përmbëllye nga Hamiltoni dhe Piastri. Vetëm pozicioni i shtatë për Leclerc. Rikthehem edhe një herë në të mirë i momentit, Max Verstappen, i cili ia del për të shtatë herë radhazi. Gjithashtu, vlen të theksohet se kjo fitore ishte e 12-ta radhazi për ekipin e Red Bull.



ODA E MIJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LËKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lëkarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: Furnizim Shërbime Punë

Nr. i Prokurimit 07-23

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtarëve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbrojt veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimin më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fron të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë**, apo përmes emailit: **info@omk-rks.org**, me titullin:

Dosja për: Kontrat për përkthim dhe lekturim të dokumenteve të OMK-së

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashkrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashkrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga data e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uecin e Odës: <https://omk-rks.org/>

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **02.08.2023 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **04.08.2023 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **04.08.2023 ora 14:00.**



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Salton Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abropa Teatri e, 4 Lullat, Pr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Albert Dina shpall të pavlefshme dëftesat e kl I – IX - SHFMU "Faik Konica" Celinë.
- Besmir Hasani shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI –IX- SHFMU "Mati Logoreci" Prizren.
- Durim Lubiceva shpall të pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellese. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerim2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpazj dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerim2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpazj dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkolës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central SA Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola CeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulal CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

